

Nr. .... Prot  
*Lutemi referoni këtë numër në përgjigje*

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2022

## **Lënda : Kthim përgjigje**

Në përgjigje të kërkesës tuaj dt 23.03.2022 ardhur në KESH sh.a. me nr prot.1486 :

-Procedurën dhe dokumentacionin përkatës mbi te cilen bazohet thirrja per **shprehje interesi per dhënie me qira** të një aseti gjenerues termik nepermjet nje impianti lundrues.

Procedura e organizuar nga ana e KESH sh.a. është bazuar në parashikimet VKM Nr. 620, date 22.10.2021, e ndryshuar.

Publikimi i realizuar e gjeni ne faqen e web te KESH sh.a.:

-Sa është vlera e shpallur fituese nga institucioni juaj, per marrjen me qira të asetit gjenerues termik nëpërmjet një impianti lundrues? Duke bashkëlidhur edhe dokumentacionin c shpalljes se operatorit fitues.

Vlera e ofruar nga ana e subjektit fitues për qiranë e asetit gjenerues termik është 63,000 \$ (gjashtëdhjetë e tre mijë) për dite. Periudhe e qiramarrjes do te jete 2 (dy) vjeçare.

-Ne kërkesat teknike to hartuara nga ana e KESH sh.a, operatori ekonomik do to ofroje me qira asetin gjenerues termik, i cili duhet të përdore karburant të lëngshëm, si gasoil (LFO) ashtu edhe mazut/solar (HFO). Në këtë aspekt, sa është sasia e karburantit qe do te duhet të përdorë aseti gjenerues termik ne dite, muaj, vit dhe gjithë kohëzgjatjen e kontratës se qirasë (2 vjet)?

Aseti Gjenerues termik ka një kapacitet gjenerues të instaluar prej 110 MW. Konsumi i lëndës djegëse për ditë, muaj dhe vit do të llogaritet bazuar në konsumin specifik për MWh të gjeneruar sipas regjimit te punës të diktuar. Konsumi i lëndës djegëse i deklaruar i aseteve të ofruara për 1 (një) MWh të gjeneruar është rreth 220 kg.

-Në detyrimet e KESH sh.a. parashikuar ne thirrjen për shprehje interesi, vete KESH sh.a do te fete përgjegjës per kryerjen e te gjitha procedurave me qellim prokurimin dhe furnizimin e impiantit me karburantin e nevojshëm për funksionim sipas metodologjisë se dakordësuar të shfrytëzimit. Sa është vlera e përlllogaritur nga ana juaj për blerje karburanti për funksionimin e asetit gjenerues termik ne dite, muaj, vit dhe gjithë kohëzgjatjen e kontratës se qirasë (2 vjet)?

Vlerë e saktë e lëndës djegëse që do të përdorë aseti gjenerues termik do të përcaktohet nëpërmjet procedurës së prokurimit të kësaj lënde në treg.

Duke qenë se shoqëria do të prokurojë këtë lëndë djegëse, çdo publikim paraprak vlerësohet se do të paragjykojë procesin e prokurimit.

Nga të dhënat që ne disponojmë, vlera ditore për furnizim me karburant për funksionimin e asetit gjenerues termik është rreth 70 mijë euro, pra një vlerë mesatare mujore 2 milionë euro, vjetore 25 milionë euro dhe sa gjithë kohëzgjatja e kontratës deri 50 milionë euro. Ne kushtet e një krize karburanti dhe rritjes së çmimit të tij, a mendoni se institucioni juaj dhe shteti shqiptar mund të përballojë një kosto kaq të lartë për vënien në punë të tij?

Modeli aktual i Tregut të Energjisë Elektrike, i miratuar nga ERE, si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 620, datë 22 Tetor 2021 për; “Miratimin e kushteve të Detyrimit të Furnizimit Publik (DFP) për të licencuarit e Sektorit Energjistik Shqiptar, gjatë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme të furnizimit me energji, për të parandaluar dhe përballuar pasojat e krizës globale të energjisë” e ngarkon KESH sh.a. me detyrimin që të sigurojë të gjithë energjinë e nevojshme për të përmbushur nevojat e Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU). Për përmbushjen e këtij detyrimi, KESH duhet të përdorë së pari energjinë e prodhuar nga asetet e veta gjeneruese duke e kombinuar me marrëveshje shkëmbimi apo depozitime, dhe në rast të mosplotësimit të kërkesës së FSHU, të blejë pjesën tjetër në tregun e parregulluar.

Detyrimi për përmbushjen e nevojave të FSHU, për rrjedhojë, e ngarkon KESH sh.a. me përgjegjësinë e sigurisë së furnizimit të Sistemit Elektro-Energjistik Shqiptar. Kriza globale energjetike e shoqëruar me ngritjen e menjëhershme të çmimeve të energjisë në tregjet rajonale së bashku me paparashikueshmërinë e lëvizjeve të tregjeve energjetike evropiane për shkak të tranzicionit energjistik, si dhe varësia e prodhimit të energjisë nga kushtet hidro-meteorologjike, e vendos KESH në një trysni jo të zakonshme financiare dhe operacionale për përmbushjen e Detyrimit të Furnizimit Publik. Nga ana tjetër, pamundësia operacionale apo financiare e KESH sh.a. për përmbushjen e DFP do të çenonte rëndë sigurinë e furnizimit të vendit me energji elektrike, gjë që do të kishte pasojat të rënda për ekonominë, sigurinë dhe jetën e qytetarëve.

Nëpërmjet VKM Nr. 757, datë 21 Dhjetor 2021, për “Disa ndryshime në VKM Nr. 620, datë 22 Tetor 2021”, Qeveria e Shqipërisë autorizon KESH sh.a., që në përputhje me nevojat dhe mundësitë që do të paraqiten, ti drejtohet tregut ndërkombëtar për të marrë përkohësisht (1-3 vjet) me qira asete gjeneruese termike shtesë, të cilat mund të instalohen dhe lidhen lehtësisht me Rrjetin e Transmetimit të Energjisë në Shqipëri, me qëllim që:

1. Të gjenerojë sasinë e nevojshme të energjisë për përmbushjen e Detyrimit për Furnizimin Publik duke mbajtur kostot e gjenerimit më ulët se çmimet e tregut të parregulluar.
2. Të mundësojë një kapacitet gjenerues rezervë për të garantuar sigurinë Furnizimit Publik dhe sigurinë e Sistemit Energjistik Shqiptar
3. Të optimizojë prodhimin e energjisë nga kombinimi i aseteve gjeneruese termike dhe hidrike për të përmbushur kërkesën e FSHU për DFP përgjatë gjithë vitit, edhe gjatë sezonit pa reshje kur çmimet e energjisë zakonisht rriten.
4. Të realizojë të ardhura shtesë nga operacionet tregtare në tregun e parregulluar duke shfrytëzuar mundësitë që ofrojnë çmimet e larta të energjisë në tregje.

Me qëllim realizimin e një krahasimi të shpenzimeve për blerje të energjisë elektrike, sqarojmë se:

- Sasia e mundshme për gjenerim nga aseti gjenerues termik është rreth 70,000 (Shtatëdhjetë mijë) MWh/Muaj.
- Çmimi i energjisë në tregjet e energjisë për periudhën Janar-Mars ka qenë rreth 223 Euro/MWh dhe pritshmëria Prill - Dhjetor është rreth 262 Euro/MWh.

Kosto e energjisë prej 70,000 MWh në tregjet e energjisë është rreth 15,600,000 (pesëmbëdhjete milion e gjashtëqind mijë)

**Faleminderit !**